



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Zvicër-Kosovë Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim (LOGOS)

Raporti final
2010 – 2012



Prishtinë
Data: Mars 2013

Tabela e përmbajtjes

Shkurtesat për emrat e Komunave	iv
Shkurtesat për emrat e stafit të LOGOS-it	iv
Harta me Zonat ku është ndëry me projekt	v
1. Informacione Themelore	6
2. Përmbledhje Ekzekutive	7
3. Hyrje	12
4. Plani i veprimit për çdo rezultat	14
4.1 Rezultati	14
4.2 Temat transversale	25
5. Financat	26
5.1 Buxheti – Shpenzimet	26
5.2 Efikasiteti	27
6. Mësimet e nxjerra	27
7. Çfarë tjetër do të dëshironim të ju themi	28

Aneksi 1: Korniza Logjike

Aneksi 2: Rezultatet e planifikuara – rezultatet e arritura

Lista e shkurtesave

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
EULEX	Misioni i Unionit Evropian për Sundim të Ligjit
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
GIS	<i>Geographical Information System</i>
GIZ/MMS	Deutsche Gesellschaft für internationale Zusammenarbeit / Modernization of Municipal Services
IC	Intercooperation
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare e përfaqësuesit Special të BE-së
PIMMN	Plani i Integruar për Menaxhim e Mbeturine të Ngurta
TI	Teknologjia Informative
ZUP	Zyrtari i ulët profesional
IZHQL	Inovacionet dhe Zhvillimi i Qeverisjes Lokale
LOGOS	Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OJQ	Organizata jo-qeveritare
RZ	Rezultati
PU	Përfundimi
ZP	Zyra Pritëse
MCP	Menaxhimi i Ciklit të Projektit
KPP	Kompani me Pronësi Publike
PFSH	Projekt me Fillim të Shpejtë
KD	Komiteti Drejtues
SDC	Agjencioni Zvicëran për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SCO	Zyra Zvicërane për Bashkëpunim
SSHÇE	Sekretariati i Shtetit për Çështje Ekonomike
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN HABITAT	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore
PRU	Plani Rregullues Urban

USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
USAID/DEMI	USAID/Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive
USAID/BEEP	USAID/Programi për Përmirësimin e Mjedisit Afarist
PVV	Plani Vjetor i Veprimit
KF	Këshilli i Fshatit


Shkurtesat për emrat e Komunave

HE	Hani i Elezit
KA	Kaçanik
KL	Kllokot-Vërbovc
KK	Kamenicë
NB	Novobërdë
PA	Partesh
RA	Ranillug
SHT	Shtërpcë
VI	Viti

Shkurtesat për emrat e stafit të LOGOS-it

NP	Norbert Pijls
MR	Mentor Rexhepi
ES	Erëmira Salihu
MB	Merita Barileva
FR	Fatime Rrahmani
DM	Dardan Maliqi
PK	Prend Krasniqi
MJ	Majlinda Jupolli

Harta me Zonat ku është ndërhy me projekt



1. Informacione Themelore

Shteti: Kosovë		Emri i projektit sipas fushës SAP „Definicioni i Projektit “ Zvicër – Kosovë Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim-LOGOS	
No SAP: 7F – 04371.02.01			
Sfera e Strategjisë së Bashkëpunimit : Sundimi i Ligjit dhe Demokracisë			
Synimi	Reformat e Qeverisjes Lokale dhe Decentralizimit në komunat jug-lindore janë forcuar, duke kontribuar në demokratizimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në një shtet dhe shoqëri multietnike		
Rezultati (RZ)	RZ 1: Komunat partnere të zgjedhura në juglindje të Kosovës janë më të përgjegjshme, transparente, të barabarta dhe efektive në qeverisje lokale dhe të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime që të plotësojnë nevojat e të gjitha grupeve të qytetarëve		
Kohëzgjatja e fazës së projektit: 01.01.2010 – 31.12.2012		Periudha e raportimit: 01.01.2010 – 31.12.2013	
SDC Buxheti në fazë (CHF)	4.706.596,00*	SDC Buxheti në vitin 2012 (CHF)	1.491.568,00*
SSHÇE Buxheti në fazë (CHF)	n.a.		n.a.
SDC mbetja në fazë (CHF)	-129.314,67	SSHÇE Buxheti në vitin 2011 (CHF)	
SSHÇE mbetja në fazë (CHF)	n.a.		
Informatat mbi partnerët dhe/ose kontributet e donatoreve tjerë (të kalkuluar në CHF) Nuk ka kontribute tjera në dispozicion			
Organizatrat zbatuese:		Intercooperation	
Partnerët kryesor vendorë	AKK – Asociacioni i Komunave të Kosovës IPPKSH - Instituti për Planifikim, Projektim, Konstruktiv dhe Shkence RECURA Financials Qendra për Trajnime, Resurse dhe Avokim (ATRC) Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (IKQL) Global Consulting & Development Associates LLC (GCDA) UBO Consulting	Partnerët kryesorë ndërkombëtar	Local Governance Innovation & Development Ltd. (Hungari) Co-PLAN (Shqipëri)
Koordinatori Nacional i Projektit	Z. Norbert Pijls	Numri i stafit në projekt	Ndërkombëtar: 2* Vendor: 9*
		Konsulent ndërkombëtar (ditët):	125*
		Konsulent vendorë (ditët):	1.162*

* Buxheti i rishikuar për LOGOS Faza e II-të është aprovuar me 15 Dhjetor të vitit 2011.

2. Përmbledhje Ekzekutive

Pikat Kryesore

1.1 Planifikimi Strategjik dhe Hapësinor

Në fund të Fazës së dytë të LOGOS-it pritet **miratimi i planeve zhvillimore komunale, zhvillimore urbane dhe planeve rregulluese** për Kamenicë, Novobërdë, Shtërpcë, Kaçanik, Ranillug dhe Klokot – Vërbovc.

Objektivi i fazës është tejkaluar në dhjetor të vitit 2012: të gjitha komunat i kanë miratuar planet strategjike dhe mjedisore në kuvendet e tyre. 4 Plane Zhvillimore Komunale, 5 Plane Zhvillimore Urbane dhe 1 Plan Rregullues Urban janë miratuar. Vetëm PZHK-ja e Kamenicës nuk u miratua. Megjithatë, numri i përgjithshëm i planeve arrin në dy plane më shumë se sa që ishte planifikuar fillimisht për këtë fazë. Vonesa në dorëzim ishte shkaktuar kryesisht sepse grupet punuese komunale nuk kishin përparuar mjaftueshëm me punën. Një tjetër vonesë ishte shkaktuar nga mosparashikimi i LOGOS-it për sasinë e përkthimit dhe shpenzimet e dizajnit. Kjo kërkonte një bashkë financim nga komunat që morri kohë për të vendosur mbi këtë. Vonesa e tretë ishte kërkesa e paplanifikuar që të gjitha Planet Zhvillimore Komunale të kenë një Vlerësim Strategjik Mjedisor(VSM). Kjo e shtyu aprovimin e PZHK-së së Kamenicës për vitin 2013.

1.2 Menaxhimi Financiar

LOGOS-planifikoi mbajtjen e **18 forumeve komunale** (takime të një shkalle të gjerë me qytetarë) Nëntë (9) forume mbi shpenzimet komunale janë planifikuar në fillimin e muajit Shkurt të vitit 2012. Nëntë (9)tjera ishin planifikuar mbi hartimin e buxhetit komunal në Gusht të vitit 2012.

Ky objektivi për vitin 2012 është arritur - në 6 muajt e parë të vitit 2012 - pak më herët se sa pritej. Një seri e 9 forumeve komunale për shpenzimet komunale u mbajt në shkurt të vitit 2012. Forumet komunale për hartimin e buxhetit 2013 u mbajtën në Qershor të vitit 2012. Ato duhet të kufizoheshin në 7 komuna, sepse fondet rezervë ishin harxhuar. Numri i lartë i pjesëmarrjes në forumet e para ka shterur buxhetin. **Objektivi i fazës për këtë indikator është tejkaluar.**

1.3 Të Hyrat Vetanake

LOGOS-i ka pritur që burimet e investuara për vitin 2011 për rritjen e bazës tatimore për tatimin në pronë (regjistrimi i të gjitha objekteve të reja të ndërtuara që nga viti 2004) do të qojë në një **rritje të mbledhjes së tatimit në pronë** gjatë vitit.

Objektivi i vitit 2012 është arritur: të gjitha komunat (përveç HE) kanë rritur në mënyrë të ndjeshme të hyrat nga tatimin në pronë. **Synimi i fazës është arritur për 7 nga 9 komunat partnere.** Rezultatet janë veçanërisht mbresëlënëse për komunat e reja të cilat me të vërtetë e kanë filluar faturimin dhe vjeljen e tatimit në pronë për vitin 2012. Përderisa viti 2012 ka mundur një faturim më të mirë, nuk është identifikuar ende një praktikë e mirë për zbatimin e vjeljes dhe pagesave përtej kushtëzimit të disa shërbimeve komunale me pagesën e tatimit në pronë.

2.1 Strukturat Komunale

LOGOS-i ka pritur gjithashtu që kuvendet komunale të **shumicës së komunave partnere do të miratojnë një rregullore komunale për bashkëpunim me nivelin nën komunal** para përfundimit të kësaj faze.

Objektivi i fazës për aprovimin e rregullores është arritur: të gjitha komunat partnere kanë miratuar një rregullore nën komunale që ndjek dispozitat udhëzuese në shabllonin e zhvilluar nga MAPL-ja dhe AKK-ja. Kjo përfshin HE, KK dhe VI, të cilat veçse kanë pasur një rregullore nën komunale mirëpo kanë shprehur dëshirën ta përshtatin me shabllonin e ri. Në fund të vitit 2012 disa komuna të caktuara i patën ndërmarrë masat e para që qonin në zbatimin e rregullores së tyre të re. (d.m.th emërimin e komisioneve të kuvendit komunal që do të udhëheqin procesin e themelimit të këshillave të fshatrave). LOGOS-do të vazhdojë me ndihmën ndaj komunave të saj partnere për zbatimin e rregullores në 2013.

Një objektivi tjetër i fazës ka qenë përmirësimi i **shërbimeve administrative** në Kamenicë. **Ky objektivi është arritur** sipas të gjithë partnerëve të projektit. Megjithatë të dhënat monitoruese janë kundërshtuese.

2.2 Menaxhimi i Mbeturinave të ngurta

LOGOS-i ka paraparë se planet për **menaxhimin e mbeturinave të ngurta për Hanin e Elezit dhe Vitisë** do të miratohen në pranverë të vitit 2012.

Ky objektivi i fazës është arritur. Hani i Elezit dhe Vitia i kanë miratuar planet në vjeshtën hershme të vitit 2012. Hani i Elezit ka filluar me zbatimin e planit menjëherë. Periudha e zbatimit ka qenë tepër e shkurtë për të marrë të dhëna të besueshme për të kontrolluar nëse plani është funksional edhe në praktikë. **Objektivi i fazës për zbatimin e planit për mbeturinat nuk është arritur.** Vonesa në rishikimin e kornizës ligjore nuk ka dhënë kohë të mjaftueshme për të vënë planet në praktikë.

2.3 Fondi Investiv

LOGOS-i gjithashtu ka pritur finalizimin e të gjitha projekteve që janë bashkë-financuar nga fondit investiv i LOGOS-it përgjatë vitit.

Objektivi është arritur për 95%: vetëm dy projekte nuk kanë pasur pranim teknik dhe raportin përfundimtar të auditimit më 31 Dhjetor. Përkundër pritjeve buxheti i kompletuar i fondit investiv është thithur në fund të vitit.

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012 dy prej projekteve me Fillim të Shpejtë në Novobërdë dhe Kllokot-Vërbovc, të gjitha projektet gjinore (9 në total) dhe të gjitha projektet e Thirrjes Komunale 1(9 në total) janë finalizuar. Në gjashtëmuorin e dytë të gjitha përveç dy projekteve (9 në total) të Thirrjes Komunale 2 janë finalizuar. Dy projektet që kanë mbetur të pakryera janë:

- Partesh: “*Ndërtimi i Etno-Shtëpisë*”. Zbatimi i ka filluar në Shtator të vitit 2012. Më 31 Dhjetor të vitit 2012 kishin mbetur edhe ca punë përbrenda lokalit. Kjo do të kryhet në pranverën e vitit 2013.
- Kaçanik: “*Ndërtimi i trotuareve për këmbësorë prej "Vëllezërit Çaka & Feriz Guri" deri në fshatin Kovaçec*”. Ky projekt ishte një projekt bonos për Kaçanikun. Zbatimi ka ngecur për shkak të një kontesti pronësor. Kjo është zgjedhur në Shkurt të vitit 2013.

2.4 Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

LOGOS-i ka planifikuar të startojë më një **kampanjë gjinore** në pranverë dhe të bëjë një **rezervim tjetër për përfshirjen gjinore në buxhetin komunal**.

Ky objektivi—e ka ngritur ndërgjegjësimin në të gjitha komunat partnere sa i përket çështjes gjinore dhe Ligjit mbi Barazinë Gjinore – **është arritur**. Fushata është zhvilluar në Mars të vitit 2012. **Objektivat për futjen e mjeteve të BPGJ-së janë arritur gjithashtu**. Në muajin Maj LOGOS-i ka organizuar një trajnim mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor(BPGJ)për të gjitha komunat partnere dhe për pikat fokale gjinore të OSBE-së. Këto trajnime rezultuan me plane veprimi për çështje gjinore për të gjitha komunat tona partnere. Këto plane janë marrë parasysh në procesin Buxhetor për vitin 2013 dhe financimi i tyre është siguruar. Ky është një zhvillim shumë pozitiv. Zyrat gjinore tani kanë një linjë të veçantë buxhetore.

Si rezultat i aktiviteteve dhe përvojave të LOGOS-it një doracak mbi BPGJ-në është publikuar dhe shpërndarë. Doracaku prezanton metodat dhe mjetet që duhet të përdoren për zbatimin e BPGJ-së dhe përmban përvojat e dy trajnimeve të organizuara nga LOGOS-më 2011 dhe 2012.

3.1 Kapitalizimi dhe shpërndarja

Objekti i fazës për marrjen e “praktikave të mira dhe përvojave nga Faza e II-të e LOGOS-it që konsiderohen relevante për hartimin politikave kombëtare” dhe “përsëritjen e praktikave të mira dhe mjeteve në mes të komunave partnere dhe jo partnere” **është arritur**.

LOGOS ka planifikuar të organizojë bashkë me AKK-në **3 deri 4 Konferenca të për gjithnjë Kosovën në lidhje me çështjet e LOGOS-it** në vjeshtën e vitit 2012. Dy konferenca janë mbajtur: një për Vjeljen e Taksave në pronë dhe një mbi Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor. Në këto konferenca LOGOS-i ka prezantuar një **video** që ka pasqyruar punën e dhënë dhe rezultatet e arritura në këto fusha. Videot me temat tjera të LOGOS-it ishin publikuar edhe më tej gjatë në fund të vitit 2012. Një marrëveshje ishte bërë me RTK-në për emetimin e të gjitha videove në pranverë të vitit 2013.

LOGOS gjithashtu ka publikuar disa **doracakë** (për tatimin në pronë, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, organizimin forumeve komunale dhe themelimin e zyrave pritëse.

Një shpërndarje e paplanifikuar ishte **zgjerimi i aktiviteteve të LOGOS-t për regjistrimin e pronave në mbarë Kosovën**. Kjo është bërë së bashku me USAID/DEMI dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës. Në fund të viti 2012 LOGOS-i kishte regjistruar 18.421 prona të reja në 12 komuna jo partnere.

Misioni i Reflektimit-Qershor 2011

Nga raporti i Misionit të reflektimit të qershorit të vitit 2011 dy rekomandime kanë mbetur për t'u ndjekur deri në vitin 2012:

- Thirrja e Dytë Komunale e Fondit Investiv ishte për “rishikimet gjinore” nga projekti i LOGOS-it: kjo është kryer gjatë muajve Mars – Maj të vitit 2012.
- Mësimet e mësuara – në fushën e përkrahjes buxhetore – ishin të dokumentuara dhe të ndara me SDC-në për të shërbyer si e dhënë për planifikim në të ardhmen: kjo është bërë në vjeshtën e vitit 2012 dhe në pranverën e vitit 2013 (me misionin e identifikimit të SDC-së).

Të gjitha rekomandimet e Misionit të reflektimit u pasuan deri në fund të fazës së II-të. Rekomandimi më i rëndësishëm - rritja e aktiviteteve të pjesëmarrjes së qytetarëve (forumet komunale) - kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në arritjen e rezultateve pozitive për rezultatin e projektit.

Përformanca në nivelin e rezultateve

Në raportin gjysmë vjetor të qershorit 2012 rezultatet për indikatorët e rezultatit të projektit treguan rënie. Fatmirësisht **rezultatet janë kthyer përsëri në fund të 2012**. Gjatë gjashtëmujorit të fundit të 2012 LOGOS-i ka mbajtur diskutime me fokus grupe në secilën komunë për të plotësuar rezultatet kuantitative me informata cilësore. Kjo kontribuoi në qartësimin e ndryshimeve në rezultate dhe ofrojë më shumë njohuri (shih Shtojcën 2 për informacione më të hollësishme për komuna).

Indikatori a) - përmirësimi i kënaqësisë së qytetarëve me punën e administratës komunale - tregoi përmirësime të qarta në fund të fazës së II-të. Për pothuajse të gjitha komunat partnere, qytetarët shprehën kënaqësinë e përgjithshme mbi ecurinë e përgjithshme të komunës së tyre (mesatarisht 75% për shqiptarët e Kosovës dhe 65% për serbët e Kosovës). Për të gjitha komunat partnere përveç VI, shkallët e perceptimeve të qytetarëve janë rritur ndjeshëm prej shifrave themelore të mbledhura në vitin 2009 dhe fillimit të LOGOS faza e II-të. Kjo është me interes të veçantë për të vëzhguar se normat e kënaqësisë së serbëve të Kosovës kanë përparuar e dukshëm që nga viti 2009 - tani më shumë se gjysma e popullsisë duket e kënaqur në lidhje me punën e komunave të tyre dhe e pranojnë progresin. Kjo foto ka treguar takimet e fokus grupit me qytetarët - Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe i referohen investimeve publike dhe infrastrukturës për të shpjeguar kënaqësinë/pakënaqësi të tyre. Projektet e financuara përmes Fondit të Investimeve LOGOS janë të referuara shumë shpesh. Ky është rasti edhe me aktivitete të tjera të tilla të LOGOS-it si ato në fushën e mbeturinave apo të zyrës pritëse.

Indikatori b) - Përmirësimi i kënaqësisë së qytetarëve me menaxhimin financiar komunal në të gjitha komunat partnere - tregoi një zhvillim të fortë në fund të fazës së II-të. Në të gjitha komunat rezultatet kalojnë në fund të objektivave të fazës që janë të përcaktuara në pranverë të vitit 2010. Komunat e Kosovës me shumicë shqiptare shënuan rezultate ndjeshëm më të larta se komuna kontrolluese e Lipjanit. Megjithatë, Komunat Serbe të Kosovës janë ende nën mesataren e rezultatit të kënaqshëm të kolegëve të tyre shqiptar të Kosovës. Fokus grupet treguan se ka një ndarje të rëndësishme sa i përket barazisë gjinore: gratë ndihen më pak të informuara rreth debateve publike mbi buxhetin. Përderisa pjesëmarrësit pranojnë ngritjen e profesionalizmit nga komunat, një kritikë e cila është përsëritur shpesh i referohet ndërlidhjeve të pakta në mes të investimeve dhe prioritetëve të qytetarëve. Mangësitë në lidhje me transparencën i bëjnë qytetarët të dyshojnë në korrupsion, që është një temë e mbuluar vazhdimisht nga shtypi dhe është në mendjen e çdo të anketuari.

Indikatori c) - rritja e kënaqësisë së qytetarëve me pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes - tregoi një rritje pozitive në fund të Fazës së II-të. Pothuajse në të gjitha komunat rezultati është më i lartë se sa në korrik të vitit 2012 dhe në disa raste gjatë fazës ka arritur një rekord të lartë. Tri komunat (2 komuna shqiptare të Kosovës dhe 1 komunë serbe e Kosovës) nuk kanë arritur objektivin e fazës. Pjesëmarrësit në fokus grupe referohen shpesh në debatet publike të organizuara nga LOGOS. Ndërsa në përgjithësi të informuar dhe të vetëdijshëm për debatet publike, shumica e femrave heqin dorë nga pjesëmarrja.

Indikatori d) – shkalla e realizimit të shpenzimeve të projekteve nga korniza komunale afat-mesme buxhetore- që ishte themeluar në fund të Fazës së II-të. Komunat tani duken gjithnjë e më shumë të afta që të parashikojnë se çfarë burime do të jenë në dispozicion për vitin vijues dhe të planifikojnë projekte me investimeve kapitale dhe zbatimin e tyre në përputhje me këtë. Në këtë aspekt, progresi është veçanërisht i dukshëm për komunat serbe të Kosovës.

Përformanca në nivel përfundimtar

Indikatorët e rezulttit 1 janë arritur – përveç zhvillimit të sistemit monitorues. Ekzistojnë lidhje të mjaftueshme në mes të buxhetimit dhe planifikimit aktual në shumicën e komunave. Niveli nën-komunal është i integruar mirë në plane me nga një kapitull të veçantë për secilin fshat. Përfaqësuesit e nivelit nën-komunal gjithashtu ishin ftuar të komentojnë në secilën fazë/pjesë të planeve. Për shkak të vonesave në dorëzimin e planeve, LOGOS-i nuk ka qenë në gjendje të asistoj në mbikëqyrjen e realizimit. Kjo është planifikuar për vitin 2013.

Indikatorët e rezulttit 2 kanë treguar një ngritje shumë të mirë. Përqindja e qytetarëve që janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet administrative dhe qasjen e perceptuar për shërbimet në Kamenicë tejkalojnë masën bazë të vitit 2009. Fatkeqësisht rezultatet janë ende nën rezultatet e synuar në përfundim të fazës. Një ngritje e fuqishme është arritur në Han të Elezit sa i përket kënaqshmërisë së qytetarëve me mbledhjen e mbeturinave të ngurta. Shifrat tregojnë qartë se hapat e parë të realizimit të planit për mbledhjen e mbeturinave të ngurta kanë rezultuar me reagime pozitive të qytetarëve. Vitia nuk ka e filluar zbatimin dhe rezultati në këtë indikator është vazhdimisht i ulët.

Indikatorët e rezulttit 3 treguan një ngritje të fuqishme gjatë 6 mujorit të fundit të Fazës së II-të. Kopjimi i shabllonit të rregullores komunale për nivelin nën-komunal dhe regjistrimi i pronave në komunat jo partnere ishte i suksesshëm për shkak të qeverisë qendrore që miratoi praktikën tona më të mira. Gjatë muajve të fundit të vitit 2012 dhe muajve të parë të vitit 2013 LOGOS-i ka publikuar dhe shpërndarë 4 doracak dhe 8 dokumentarë përgjatë gjithë Kosovës

3. Hyrje

Përshkrim i shkurtër i projektit

Zvicër – Kosovë Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim (LOGOS) ishte pjesë e programit shtetëror të Agjencisë Zvicerane për Zhvillimin dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë. Faza e dytë e LOGOS-it ka zgjatur nga janari i vitit 2010 deri në dhjetor të vitit 2012.

Në këtë fazë LOGOS-i ka kontribuar në zhvillimin e qëllimit vijues: qeverisja lokale dhe reformat e decentralizimit në Kosovën juglindore janë forcuar, duke kontribuar kështu në demokratizim dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në një shtet dhe shoqëri shumë-etnike. Rezultati i projektit LOGOS Faza e II-të ishte se komunat e përzgjedhura partnere në Kosovën Juglindore janë më të përgjegjshme, transparente, të paanshme dhe efektive në qeverisjen lokale dhe janë të afta që të ofrojnë shërbime kyçe për të kënaqur të gjitha grupet e qytetarëve. Rezultati i projektit të lartpërmendur është ndjekur përmes përqendrimit në tri fushat punuese: 1. Planifikimi dhe menaxhimi i burimeve; 2. Administrata dhe Shërbimet Publike; 3. Kapitalizimi dhe shpërndara e përvojave.

LOGOS-i kishte definuar një sërë strategjishë: përkrahja ishte përqendruar në fuqizimin e kapaciteteve në nivel komunal. Projekti në një anë i përmirësonte kapacitetet e qeverisjes lokale për të planifikuar dhe realizuar zhvillimet dhe të ofroj shërbime për qytetarët dhe komunitetet, dhe në anën tjetër, ka siguruar që kanalet e duhura të jenë në dispozicion të shoqërisë civile dhe komunitetit për të shprehur shqetësimet e tyre. E gjithë ndihma e siguruar për komunat është bazuar në një vlerësim të kujdesshëm dhe të detajuar të nevojave të tyre, përderisa u ofrua një nivel i caktuar i fleksibilitetit dhe aftësisë për t'iu përgjigjur kërkesave të reja. Projekti siguroi se njohuria e marr përmes këshillimeve dhe trajnimeve mund të transformohet në aftësi praktike dhe më tej në ndryshime të sjelljeve. LOGOS faza II-të balancon asistencën e butë (këshillimin dhe trajnimin) me investime në pajisje (fonde të investimeve)

Në fazën e dytë LOGOS-i ka pasur partner komunat vijuese: Kllokot-Vërbovc, Ranillug, Novobërdë, Shtërpce, Hani i Elezit, Kamenica, Kaçanik, Viti, dhe Partesh (e shtuar në pranverë të vitit 2011). Një buxhet prej 4.712.845 CHF është planifikuar për fazën e dytë. Ky buxhet përfshinë një fond të investimit prej 1.310.000 CHF.

Evolucioni i kontekstit

Evolucioni i kontekstit politik

Konteksti politik i LOGOS-it në mes të muajit Janar 2012 dhe Dhjetor 2012 ishte **mjaft dinamik**. Megjithatë lejoi që komunat të ushtrojnë detyrat e tyre.

Viti **2010** tregoi një përfshirje të mëtejshme të qëndrueshme të Serbëve të Kosovës në institucionet e Republikës së Kosovës. Hapi kryesor në këtë drejtim ishte themelimi i komunës së re të Parteshit që ishte përfshirë me LOGOS-in si komunë partnere. Një hap tjetër në inkuadrimit të Serbëve të Kosovës ishte përfshirja e tyre në bordin e Asociacionit të Komunave të Kosovës për herë të parë që prej themelimit të tij.

Një zhvillim tjetër në kontekstin politik të LOGOS-it ishte rënia e Qeverisë Kombëtare në nëntor të vitit 2010. Kjo ka dërguar në zgjedhjet parakohshme më 5 Dhjetor. Për arsye se LDK u tërhoq nga qeveria përfaqësuesit e saj në qeveri i lanë postet e tyre gjithashtu. Në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministri Sadri Ferati dhe zëvendës Ministri Shpend Tërdevaj i lanë pozitat e tyre.

Më **2011** si zhvillim kryesor ishte efekti i ndikimit negativ i tensioneve në veri të Kosovës në komunitetin Serb poshtë lumit Ibër. Një zhvillim i dytë politik për kah rëndësia ishte arritja e misionit të FMN-së që sugjeroi ndryshime në mënyrën se si qeveritë lokale në Kosovë duhet të financohen.

Në vitin **2012** zgjedhjet në Serbi i ngrinë negociatat e ri-filluara mes Serbisë dhe Kosovës mes Shkurtit dhe Majit të vitit 2012. Zgjedhja e presidentit nationalist në Serbi i vonoi edhe më tej bisedimet. Në fund të vitit negociatat për arritjen e një marrëveshjeje për veriun e Kosovës u intensifikuan.

Evolucioni i kontekstit ligjor

Evolucioni i kontekstit ligjor të LOGOS-it në mes të muajit Janar 2010 dhe Muajit Dhjetor 2012 u karakterizua me **vonesa të shumta**. Kjo gjë në rastin e mbledhjes së mbeturinave e frustroi punën e komunave.

Rënia e qeverisë në Nëntor të vitit **2010** i shtyu të gjitha amendamentimet dhe rishikimet e ligjeve. Kjo shkaktoi pasiguri në fushën menaxhimit të mbetjeve të ngurta –një fushë ku LoGOS-it iu deshën ndryshime ligjore.

Korniza ligjore për pushtetin- lokal nuk u ndryshua gjatë vitit **2011**. Përgjatë vitit kishte mjaft diskutime në mes të qeverisë qendrore, AKK-së dhe kryetarëve të komunave rreth ndryshimit të ligjit mbi mbeturinat dhe ligjit mbi Kompanitë Publike për ti lejuar komunave një rol më të pavarur në menaxhimin e mbeturinave të ngurta. Në fund të vitit një marrëveshje ishte arritur në mes të gjitha palëve se si të ndryshohen ligjet. Gjatë pjesës së dytë të vitit 2011 filloi një diskutim rreth barrës së tatimeve komunale në ekonominë lokale, pjesës së ulët të tatimeve komunale në buxhetin komunal dhe vjeljes shumë zhgënjyese të tatimit në pronë (taksa komunalë që i kontribuon më së shumti buxhetit komunal). Ky diskutim morri një rëndësi të re më lëshimin raportit të FMN-së në fund të vitit 2011 në të cilin një ristrukturim radikal i financave komunalë ishte propozuar.

Korniza ligjore ndryshoi pozitivisht gjatë vitit **2012**. Së pari, më 8 qershor 2012 Ligji për mbeturinat (Ligji Nr .04/L-060) u aprovua nga presidenti i Republikës së Kosovës. Ky ligj i ri në mënyrë të qartë përcakton kompetencat e plota për komunat në menaxhimin e mbetjeve të ngurta në territorin e tyre. Së dyti, më 17 maj 2012 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr 04/L-111) u aprovua nga presidenti. Ky ligj mundëson që komunat të kenë në pronësi të vet kompanitë (ndërmarrjet) publike. Një tjetër zhvillim në kornizën ligjore kishte të bëjë me mekanizmat e zbatimit që komunat përdorin për të mbledhur taksat dhe tarifat. Së pari, Ministria e Brendshme filloi të zbatojë regjistrimin e të gjitha makinave të banorëve të Kosovës, sipas legjislacionit të Kosovës. Kjo ka ndikuar kryesisht tek serbët e Kosovës të cilët kishin vazhduar përdorimin e targave ë vjetra serbe apo targave të OKB-së. Përkundër disa ankesave nga ana e komunitetit serb të Kosovës shumica e regjistrimeve janë bërë në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012. Regjistrimi i automjeteve sipas ligjit në Kosovë u mundëson komunave zgjatjen e afatit të regjistrimeve (që duhet të ndodhë për çdo vit) për pagesën e tatimit në pronë.

Evolucioni i kontekstit të projektit

Evolucioni i kontekstit të projektit gjatë fazës së II-të ishte i **qetë**. Në vitin 2011 Intercooperation dhe HELVETAS u shkrinë në një organizatë. Ky ndryshim u zbatua normalisht në ekipin e Intercooperation të Kosovës. Gjatë fazës së II-të një numër i donatorëve tjerë i filluan projektet fushën e qeverisjes lokale dhe decentralizimit. Përkundër mungesës së koordinimit të donatorëve LOGOS-i ishte në gjendje të zhvillojë marrëdhënie konstruktive dhe të këndshme pune me të gjitha projektet. Me USAID/DEMI dhe IGZ/MMS u zbatuan aktivitete të përbashkëta.

4. Plani i veprimit për çdo rezultat

4.1 Rezultati

Rezultati 1	Komunat partnere të zgjedhura në juglindje të Kosovës janë më të përgjegjshme, transparente, të barabarta dhe efektive në qeverisje lokale dhe të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime që të plotësojnë nevojat e të gjitha grupeve të qytetarëve
--------------------	---

Indikatorët Rezultati 1	Komuna e synuar		Baza 2009	Vlera 2010	Vlera 2011	Vlera në Korrik 2012	Vlera në fund të fazës 2012	Synimi në fund të fazës 2012
RZ 1 a. Rritja e kënaqësisë së qytetarëve (sipas specifikës gjinore) me performancën e administratës komunale në të gjitha komunat partnere ¹	HE	Meshkuj	65.9 %	99 %	85.1%	68.2%	96.9%	75.9%
		Femra	44.9 %	89.2 %	71.2%	42.86%	90%	54.9%
	KA	Meshkuj	82.2 %	70.3 %	87.3%	74.6%	79.4%	92.2%
		Femra	63.7 %	54.7 %	96.9%	63.8%	74%	73.7%
	KL	Meshkuj	N.A.	37.2%	56.5%	60.5%	61.4%	45%
		Femra	N.A.	35.4 %	72.1%	63%	69.6%	45%
	KK	Meshkuj	82.2 %	82.8 %	75.9%	65.3%	78.7%	92.2%
		Femra	63.7 %	75.7 %	85.9%	53.7%	82.3%	73.7%
	NB	Meshkuj	55.5 %	77.8 %	84.7%	86.0%	82.9%	65.5%
		Femra	66.7 %	75.5 %	88.6%	61.7%	67.4%	76.7%
	PA	Meshkuj	N.A.	21.3 %	85.1%	71.4%	63.6%	45%
		Femra	N.A.	18.6 %	17.8%	56.3%	52.1%	45%
	RA	Meshkuj	N.A.	20.0 %	25%	59.5%	77.5%	45%
		Femra	N.A.	13.0 %	21.3%	44.9%	66.7%	45%
	ST	Meshkuj	18.0 %	35.5 %	42.5%	17.1%	59.6%	58.8%
		Femra	19.1 %	28.9 %	44.2%	16.3%	48.8%	59.1%
VI	Meshkuj	80.0 %	44.7 %	63.8%	66.3%	42.6%	90%	
	Femra	80.3 %	37.2 %	51.8%	45.3%	60%	90.3%	
Mesatarja e Komunave Shqiptare të K ²	Meshkuj		77.5%	74.4%	78%	68.6%	74.4%	87.5%
	Femra		63.1%	64.2%	76%	51.42%	76.5%	73.1%
Mesatarja e Komunave Serbe të K ³	Meshkuj		37.1%	38.36%	58%	58.9%	69%	51.8%
	Femra		42.9%	34.2%	48%	48.4%	60.9%	54.1%
Komuna kontrolluese - Lipjan	Femra		70.8%	63.7%	83.5%	59%	77.9%	N.A.
	Meshkuj		54.1%	43.2%	93.7%	68.4%	69.6%	N.A.

¹ Burimi i verifikimit: Mozaiku Kosovar – Anketa e autoriteteve Lokale dhe Shërbimeve Publike dhe Anketa UBO 2010 & 2011 dhe 2012: Q18c, Përgjigje pozitive të akumuluara (shumë të kënaqur + të kënaqur) Përdorët nga SCO për monitorimin e LOGOS-it (RLD Rezultati K1.1 dhe CH1.3

² Komunat partnere përmbajnë një numër të madh të shqiptarëve të Kosovës janë si në vijim: Hani i Elezit (HE), Kaçanik (KA), Kamenicë (KK) dhe Viti (VI)

³ Komunat partnere që përmbajnë një numër të madh të serbëve të Kosovës janë si në vijim: Kllokot-Vërbovc (KL) Novobërdë(NB), Partesh (PA), Ranillug (RA) dhe Shtërpcë (ST)

Komentet për RZ1a:

Në fund të Fazës së II-të, mund të thuhet:

- Pothuajse në të gjitha komunat partnere, në përgjithësi qytetarët janë ndarë të kënaqur mbi ecurit e përgjithshme të komunave të tyre (mesatarisht 75% për K/Sh dhe 65% për serbët e Kosovës)
- Ndryshime me kalimin e kohës? Nga të gjitha komunat partnere, përveç të VI, normat e perceptimeve të qytetarëve janë rritur që nga mbledhja e të dhënave primare dhe fillimi i projektit LOGOS Faza e II-të.
- Në këtë pikëpamje, është arritur një progres mbi normën e kënaqësisë së serbëve të Kosovës që nga viti 2009, ku më shumë se gjysma e popullatës është ndarë e kënaqur mbi ecuritë e komunave të tyre.

Këto rezultat të cilat në përgjithësi janë pozitive, janë konfirmuar gjatë diskutimeve me anketues të përzgjedhur në mënyrë rastësore për të qenë pjesë e fokus grupeve të organizuara për të gjitha komunat partnere.

HE: Në rastin e HE-së, progresi i performancës i atribuohet punës së kryetarit aktual, i cili është paraqitur si transparent dhe i gatshëm. Pjesëmarrësit gjithashtu përshkruan komunën si transparente edhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje komunale. Pjesëmarrësit e shfaqën kënaqësinë e tyre sa i përket investimeve të bëra nga komuna, kryesisht ndërtimin e rrugëve, ndriçimit publik dhe menaxhimit të mbeturinave. Sipas tyre, problemet e vazhdueshme vazhdojnë të jenë në fushat infrastrukturës së ujit dhe të shëndetësisë.

KA: Shumica e pjesëmarrësve dhe posaçërisht femrat theksuan që kualiteti i shërbimeve të ofruara është përmirësuar gjatë viteve të fundit. Komuna është paraqitur si gjithnjë e më transparente dhe informuese ndaj qytetarëve të saj. Në anën tjetër shumica e qytetarëve janë përqendruar në aspektin e: turbulencat politike (largimi i Kryetarit të komunës, zgjedhjet e reja) të vitit të kaluar, lokacionin e investimeve, furnizimin me ujë dhe shërbimet shëndetësore. Femrat gjithashtu kanë insistuar në nevojën për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave.

KK: Në përgjithësi, qytetarët e intervistuar janë ndarë të kënaqur me punën e komunës dhe progresin e bërë në këtë fushë. Diskutimet gjatë fokus grupeve megjithatë kanë zbuluar një ndarje ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale, ku kjo e fundit ndihet e neglizhuar sa i përket investimeve publike. Në përgjithësi qytetarët janë ndarë të kënaqur me zgjedhjen dhe cilësinë e investimeve publike. Përmirësimi i procedurave administrative (p.sh. Zyra pritëse) erdhi si përmirësim pozitiv në komunë.

KL: Pjesëmarrësit në përgjithësi janë ndarë të kënaqur me cilësinë e performancës së komunës. Të gjithë pjesëmarrësit dhe posaçërisht K/Sh kanë theksuar që ka pasur përmirësime të dukshme gjatë viteve të fundit. Investimet në infrastrukturë janë përmendur si faktor kyç për këto përmirësime pozitive.

NB: Normat e larta të kënaqësisë, kryesisht sa i përket investimeve publike (rrugët, trotualet, ndalesat e autobusëve, etj) janë diskutuar. Ekziston një ndarje e caktuar në perceptimin e femrave dhe meshkujve mbi performancën e komunës, ku gratë kanë shfaqur shqetësimet e tyre për cilësinë e investimeve publike dhe shërbimeve, duke qenë me të vërtetë kritike në lidhje me sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe cilësinë e informimit publik. Të gjithë pjesëmarrësit theksuan problemet e vazhdueshme në sektorin e ujit dhe të shëndetësisë.

PA: Pjesëmarrësit e fokus grupeve kanë insistuar mbi përmirësimet të cilat ata kanë qenë dëshmitar që nga zgjedhjet (e para) dhe kanë referuar mbi të gjitha investimet e reja publike për ti paraqitur këto ndryshime (në disa raste janë përmendur përmirësimet e etno-shtëpisë ose trotuareve). Kritika është përqendruar në transparencë, ndërkohë që të gjithë pjesëmarrësit kanë pranuar përmirësime në këtë drejtim, ata thonë se duhet bërë më shumë për informimin e qytetarëve.

RA: Është interesante se si diskutimet në fokus grupe çuan në kritika të rëndësishme të komunës. Pjesëmarrësit thanë se ata nuk ishin të kënaqur me performancën e komunës dhe përmendën se progresi ka qenë shumë i limituar. Kjo veçanti u diskutua për pjesën e popullatës të cilët banojnë në fshatrat e largëta. Ata theksuan se investimet publike janë kufizuar dhe përqendruar në qendër të komunës. Përderisa përmirësimet në transparencë janë pranuar nga të gjithë pjesëmarrësit, ndërsa gratë në veçanti thanë se situata e tanishme nuk është e mjaftueshme. Për të përmbledhur: pjesëmarrësit ishin mjaft kritik sa i përket performancës së komunës "ne terme absolute" mirëpo ishin shumë të qartë në faktin që ka pasur progres në krahasim me situatën e tre viteve të mëparshme.

SHT: Është interesante të shihet se si diskutimi në këtë fokus grup ka paraqitur ndarjet ndërmjet anketuesve K/Sh dhe K/S (ku nuk është njësoj si me rastin e RA, KL, dhe NB). Serbët e Kosovës në përgjithësi ishin më shumë të kënaqur me performancën e komunës dhe numrin e investimeve publike. Ndërsa sa i përket anketuesve shqiptar të Kosovës ata u ndien të neglizhuar rreth investimeve publike dhe besojnë që serbëve e Kosovës është duke ju ofruar prioritet. LOGOS nuk e njih këtë kritik pasi që njëra nga investime e mëdha (nga 3 investime në përgjithësi) është bërë në një shkollë në një fshat të banuar me Shqiptar. Nga të dy komunitet kritika është përqendruar në mungesë të investimeve në shërbimet shëndetësore. Mirëpo të dy palët pajtohen në përmirësimin e cilësisë së administrimit, në përmirësimin e transparencës (informacionet publike ende janë cilësuar si të pamjaftueshme) dhe në faktin se është e lehtësuar mënyra për t'i kontaktuar zyrtarët komunalë.

VI: Diskutimi tregon se komunitetet nga zonat rurale janë ndier të neglizhuar sa i përket investimeve publike. Për më tepër, të gjithë pjesëmarrësit kanë deklaruar që ata nuk janë të kënaqur me shërbimet e mbeturinave dhe të shëndetësisë në veçanti. Të gjithë pjesëmarrësit kanë pranuar progresin sa i përket transparencës dhe informimit publike, por megjithatë kanë qenë kritik në numrin (e pamjaftueshëm) të debateve publike në vit.

Vërejtjet përfundimtare

- Përveç në rastin e SHT, një ndarje e vërtetë në mendim ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës nuk mund të shihet. Në rastin e SHT, ndarja mund të bëhet rreth ndarjeve urbane-rurale. Për më tepër, shqiptarët e Kosovës që jetojnë në SHT pranojnë qëndrimin pozitiv të kryetarit të komunës dhe administratës së tij ndaj komunitetit të tyre.
- Rezultatet e fituara në këtë mënyrë kanë tendencë për të treguar rritje në besimin e serbëve të Kosovës në drejtim të komunave të sapokrijuara.
- Shumica e pjesëmarrësve i janë referuar investimeve publike dhe ato të infrastrukturës për të treguar kënaqësinë /pakënaqësinë e tyre.
- Projektet e financuara përmes Fondit të Investimeve të LOGOS-it janë referuar mjaft shpesh. I tillë është rasti i aktiviteteve tjera të LOGOS-it, si në fushën e mbeturinave ose të zyrës pritëse, ndërsa kjo e fundit i atribuohet CARITAS-it.
- Problemet e referuara më së shumti janë ato të menaxhimit të mbeturinave dhe shëndetësisë
